



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Kryetari i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja a e Statutit të Komunës së Prishtinës, të nenit 9, pika ¼ e Udhëzimit administrativ nr. 27/2012 të MPB-së dhe nr. 03/2012 të MAPL-së, të datës 22.08.2012, për këshillat komunalë për siguri në bashkësi, dhe të nenit 7.3 të Ligjit nr. 04/L-76, për policinë,

th ë r r e t

mbledhjen e tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, e cila do të mbahet më 05.07.2022, duke filluar në orën 10.00h

Mbledhja do të mbahet në objektin e vjetër të Komunës në sallën e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Për këtë mbledhje propozon këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Kthimi i qytetarëve tanë me banim të përkohshëm në botën e jashtme, çështja e sigurisë dhe shërbimet administrative;
4. Raportim mbi organizimin e aktiviteteve Manifesta 14 Prishtina 2022;
5. Përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e Komunës;
6. Të ndryshme;

Prishtinë, më 14.06.2022

Kryetari i Komunës
Përparim Rama



Faqe 1 nga 1